

Numri i Gazetës Zyrtare: 79/25

Data e publikimit në Gazetën Zyrtare: 14.04.2025

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMISË SË UJËRAVE

Në bazë të nenit 74 paragrafi (12) të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/17, 28/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 152/19, 244/19, 275/19, 110/21, 123/22, 65/23 dhe 218/24), ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave miraton:

RREGULLOREN PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN, MËNYRËN E REGJISTRIMIT, DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM DHE FSHIRJEN NË EVIDENCËN E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet forma, përmbajtja, mënyra e regjistrimit, dokumentacioni i nevojshëm dhe fshirja nga evidenca e kooperativave bujqësore.

Neni 2

(1) Evidenca e kooperativave bujqësore mbahet në formë elektronike.

(2) Forma dhe përmbajtja e evidencës së kooperativave bujqësore nga paragrafi (1) i këtij neni jepet në Shtojcën, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 3

(1) Regjistrimi në evidencën e kooperativave bujqësore bëhet në bazë të kërkesës së paraqitur nga kooperativa bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), brenda një afati prej së paku 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Pas pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, personi zyrtar i autorizuar nga Ministria që udhëheq procedurën për regjistrimin në evidencën e kooperativave bujqësore mbledh dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim për gjendjen aktuale të subjektit nga Regjistri Qendror dhe Regjistri për persona juridikë të tjerë;
- Vendim për regjistrim të kooperativës bujqësore në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore për çdo anëtar të kooperativës veçmas dhe për vetë kooperativën;
- Numri statistikor i kooperativës bujqësore.

(3) Dokumentacioni i nevojshëm nga paragrafi (2) i këtij neni sigurohet nga personi zyrtar i autorizuar nga Ministria që udhëheq procedurën për regjistrim në evidencën e kooperativave bujqësore përmes sistemeve elektronike të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Regjistrit të vetëm të ekonomive bujqësore.

(4) Nëse të dhënat nga kërkesa e paragrafit (1) të këtij neni dhe dokumentacioni i nevojshëm nga paragrafi (2) i këtij neni nuk ekzistojnë në sistemet elektronike të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Regjistrit të vetëm të ekonomive bujqësore, kërkesa refuzohet si e pabazuar.

(5) Evidenca e kooperativave bujqësore, si dhe kërkesat dhe dokumentacioni i nevojshëm ruhen në dosje të veçantë në formë elektronike.

(6) Të dhënat në evidencën e kooperativave bujqësore përditësohen nga personi zyrtar i autorizuar nga Ministria që udhëheq procedurën për regjistrim në evidencën e kooperativave bujqësore, në bazë të detyrës zyrtare çdo 90 ditë ose me kërkesë të palës së interesuar.

(7) Evidenca e kooperativave bujqësore është publikisht e disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë.

Neni 4

Nëse gjatë kontrollit për përditësim të të dhënave nga neni 3 paragrafi (6) i kësaj rregulloreje, personi zyrtar i autorizuar nga Ministria që udhëheq procedurën për regjistrim në evidencën e kooperativave bujqësore konstaton se kooperativa bujqësore nuk i plotëson kushtet për të qenë e regjistruar në evidencën e kooperativave bujqësore, në lidhje me numrin minimal të anëtarëve, statusin aktiv të veprimtarisë, regjistrimin në Regjistrin tregtar dhe Regjistrin e personave juridikë të tjerë, si dhe kryerjen e veprimtarisë, në atë rast kooperativa bujqësore fshihet nga evidenca e kooperativave bujqësore.

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-4580/1

7 prill 2025

Shkup

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë

dhe Ekonomisë së Ujërave,

Cvetan Tripunovski

Numri i Gazetës Zyrtare: 79/25

Data e publikimit në Gazetën Zyrtare: 14.04.2025

Shtojcë: Evidenca e kooperativave bujqësore

EVIDENCA E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE				
Emri i kooperativës bujqësore				
Selia e kooperativës bujqësore				
Numri unik tatimor i kooperativës bujqësore				
Numri amë i kooperativës bujqësore				
Veprimtari prioritar e kooperativës bujqësore				
Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar				
Të dhënat kontaktuese të kooperativës bujqësore	Posta elektronike		telefoni	

LISTA E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE											
Nr. rendor	Emri i kooperativës bujqësore	EMBG	Numri i anëtarëve	Numri i fermerëve të rinj	Numri i grave	Numri i personave të autorizuar që janë gra	Numri i prodhuesve organikë	Sipërfaqja totale e pronës bujqësore më m2	Kategoria e prodhimit blegtoral	Numri total i kafshëve sipas kategorive	Data e themelimit të kooperativës bujqësore
1.											
2.											
3.											
4.											
5.											

LLOGARITË VJETORE		
Nr. rendor	Emri i kooperativës bujqësore	Të ardhurat totale për vitin
1.		
2.		
3.		
4.		

5.		
----	--	--